



Pranimë / Dorezuar Pamjesuar/Busdato Received/Devisy	05-05-2023	3	vendi godit Vjeçari
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shitja e Protog. Appendix	Sasia Koliciteti Quantity
SKMSTHOC	4118/2023		118



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.634/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.634/2023 e datës 13.04.2023 të ankuesit

kundër Vendimit KA.nr.15/2023 të datës 09.03.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.634/2023 e datës 13.04.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.15/2023 i datës 09.03.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 22.08.2022 ka shpallur konkursin me numër reference KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-015 për Prokurorinë Themelore në Gjakovë (një pozitë) dhe Prokurorinë Themelore në Prizren (një pozitë). Tutje në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është përfshirë në fazat e procedurës (listën e shkurtër, testin me shkrim dhe testin me gojë), mirëpo pas publikimit të njoftimit për kandidatët e suksesshëm për Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren të datës 06.10.2022 ankuesi nuk ka rezultuar si kandidatë i suksesshëm.

Ankuesi më datë 08.11.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 18.11.2022 ka nxjerr Vendim me numër KA.nr.38/22 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare për Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër KA.nr.38/22 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës përmes postës me datë 19.12.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 21.12.2022 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.1234/2022 me numër protokolli 8260/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 01.02.2023 ka nxjerr Vendimin A.nr.1234/2022 përmes të cilit ka aprovuar ankesën e ankuesit, ka shfuqizuar Vendimin me numër KA.nr.38/22 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek ky komision.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës sipas Vendimit A.nr.1234/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.03.2023 ka nxjerr Vendim KA.Nr.15/2023 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 06.10.2022 për kandidatet e suksesshëm për Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër KA.Nr.15/2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës përmes postës me datë 11.04.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 13.04.2023 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.634/2023 me numër protokolli 3523/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e vendosjes në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova: Ankesën e datës 13.04.2023 me numër protokolli 3523/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin e datës 11.04.2023; Vendimin me numër KA.Nr.15/2023 të datës 09.03.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimit A.nr.1234/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 21.12.2022 me numër protokolli 8260/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.38/22 të datës 18.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Ankesën e datës 08.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKPK; Kërkesë për çasje në dokumentet publike e datës 27.10.2022 e parashtruar nga ankuesi; Plikon e datës 19.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 8415/2022 e datës 23.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 74/2023 e datës 06.01.2023; Procesverbalin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 14.11.2022; Dëshmi nga libri I pranimit i datës 18.11.2022; Njoftimin për përhedhjen përfundimtare i datës 06.10.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Raportin Final i rekomandimit nga Komisioni

Rekrutes i datës 30.09.2022 për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Rekomandimin për emërim i datës 30.09.2022 për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Vendimin DPSKPK/Nr.415/2022 i datës 08.09.202 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 06.09.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Vendimin DPSKPK.Nr.408/2022 i datës 06.09.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Konkurs me referencë KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-015 i datës 22.08.2022; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Formularin për përmbledhje e vlerësimeve individuale të listës së ngushtë i datës 12.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Formularin e vlerësimeve individuale për listën e ngushtë i datës 12.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Listën përfundimtare e përzgjedhës së listës së ngushtë datës 12.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Njoftimi i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë për pozitë për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Deklaratën për mos ekzistimin e konfliktit të interesit e datës 12.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Formularin për përcaktimin e kriterëve për përfshirje listën e ngushtë për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Formularin për renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Formularin për përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Formularin e vlerësimit individuale të intervistës me gojë për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Njoftimin e datës 23.09.2022; Listën e thirrjeve të kandidatëve për intervistë me gojë për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Listën përfundimtare të përzgjedhjes së testit me shkrim e datës 20.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Formularin e përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Formularët individuale përfundimtar të kandidatëve për testim me shkrim dhe me gojë të datës 29.09.2022; Testin me shkrim të ankuesit dhe kandidates i datës 16.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë; Çelësin e përgjigjeve të testit me shkrim; Aplikacionin për punësim të ankuesit për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë i datës 01.09.2022; Kartel identifikimi e ankuesit; Diplomën me Nr.406 e datës 22.01.2018 për ankuesin; Diplomën e datës 19.02.2021; Certifikatë e Notave e datës 27.02.2018; Vërtetim notash i datës 05.11.2020; Vendim me numër 1051-1/2021 i datës 11.10.2021; Certifikatën për kryerjen e stazhit të praktikës e datës 27.03.2019; Diplomën e datës 15.01.2015, 01.11.2015; Certifikatën e datës 06.10.2020 e ankuesit; Letër rekomandim i datës 05.07.2022 për ankuesin; Vendimin Reëf.Nr.266/2248 i datës 19.07.2021; Aplikacionin për punësim i kandidates për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Gjakovë i datës 05.09.2022; Diplomën me Nr. 1751/21 e datës 31.08.2021 për kandidaten D.B; Reference Ap.nr.42/2022 e datës 01.09.2022 për kandidaten Kontrate për punë praktike vullnetare në prokurorinë e shtetit e datës 01.12.2021; Referencë e datës 01.09.2022; Vërtetimin e datës 25.08.2022; Vërtetimin AP.nr.128/2018 i datës 24.09.2018; Referencës e datës 18.10.2021; Dokument identifikimi për kandidaten Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë e datës 25.08.2022; Provat për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren-Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare e datës 06.10.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Rekomandimin për emërim i datës 03.10.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Raportin final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 30.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin

Themelore në Prizren; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 30.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës e datës 30.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të intervistës e datës 30.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Formulari i vlerësimit të intervistës me gojë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Lista përfundimtare e përzgjedhjes të testit me shkrim për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Përmbledhje e vlerësimeve individuale të testit me shkrim për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Formularin e vlerësimit individual përfundimtar për testim me shkrim dhe me gojë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Njoftimin e kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Listën përfundimtare të përzgjedhjes së listës së ngushtë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Formulari i vlerësimit individual për listën e ngushtë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Testin me shkrim të datës 16.09.2022 të ankuesit dhe kandidatit për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Aplikacionin për punësim të kandidatit për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren i datës 01.09.2022; Dokument identifikimi; Kontratë për punë praktike vullnetare me Nr. 9 e datës 28.05.2021; Certifikatën AGJ.nr.120/2022 e datës 28.02.2022; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 14.04.2022; Diplomën me Nr. 7118 e datës 01.11.2020 për Aplikacionin për punësim të ankuesit i datës 29.08.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorin Themelore në Prizren; Kartel identifikimi e ankuesit; Diplomën me Nr.406 e datës 22.01.2018 për ankuesin; Diplomën e datës 19.02.2021; Certifikatë e Notave e datës 27.02.2018; Vërtetim notash i datës 05.11.2020; Vendim me numër 1051-1/2021 i datës 11.10.2021; Certifikatën për kryerjen e stazhit të praktikës e datës 27.03.2019; Diplomën e datës 15.01.2015, 01.11.2015; Certifikatën e datës 06.10.2020 e ankuesit; Letër rekomandim i datës 05.07.2022 për ankuesin; Vendimin Reëf.Nr.266/2248 i datës 19.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.15/2023 të datës 09.03.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendon se gjatë këtij konkursi ka pasur shkelje procedurale dhe materiale, konkretisht ka pasur vlerësim jo real të testit me shkrim dhe nuk janë publikuar pikët e testit me shkrim dhe me gojë; në testin me gojë për Prokurorinë Themelore në Gjakovë njëri nga anëtarët e komisionit për njohuritë që lidhen me vendin e punës më ka vlerësuar më zero pikë ndërsa anëtarët e tjerë me kanë vlerësuar me pikë të tjera, andaj Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se konkursi për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 2"-një (1) pozitë në Prokurorinë e Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore të Prizren, kriteret kanë qenë: *Përgatitja profesionale dhe kualifikimi: Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik dhe Përvoja e Punës- Një (1) vit përvojë të punës profesionale".*

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Ushtruesi i Detyrës i Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës përmes Vendimit DPSKPK/Nr.408/2022 të datës 06.09.2022 ka themeluar Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil në përbërje prej pesë (5) anëtarësh, ndërsa më datë 08.09.2022 përmes Vendimit DPSKPK/Nr.415/2022 është bërë plotësim ndryshimi i vendimit të datës 06.09.2022, ndërsa pozitat e anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës kanë qenë si në vijim: 1. Administrator i Prokurorisë, PSRK-kryesues; 2. Zyrtar i Lartë për Integrim Evropian, SKPK-anëtar; 3. Bashkëpunëtor Profesional-Prokuroria Themelore në Gjakovë-anëtar; 4. Bashkëpunëtor Profesional-Prokuroria Themelore në Prizren-anëtar; dhe 5. Zyrtare Ligjore, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës-anëtare, veprim ky në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 7 paragrafi ku përcaktohet se: "Institucionet themelojnë një komision përzgjedhës ad-hoc të shërbimit civil (në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarët të cilët kanë pozita më të lartë se pozitat që duhet të rekrutohet, por një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumë etnik dhe përfaqësim gjinor. KPSHC zhvillon procedurat e rekrutimit për pozitat e karrierës dhe të jo karrierës.", ngase sipas aktit të emërimit të datës 03.01.2018 dhe atij të datës 27.07.2018, sikurse Ndryshimit dhe Plotësimin të akteve të emërimit të datës 11.03.2022 dhe atij të datës 01.03.2022 si dhe Aktit të emërimit të datës 13.05.2015, katër (4) anëtarët e parë sipas renditjes kanë pozita më të larta se pozita që rekrutohet, ndërsa pozita e anëtares së pestë është pozitë ekuivalente me pozitën që rekrutohet, sikurse komisioni i themeluar ka përmbushur edhe kriterin gjinor dhe etnik.

Kolegji i Këshilli nga dosjet e administruara të kandidatës së përzgjedhur për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë sikurse edhe të ankuesit, ka gjetur se ankuesi posedon Diplomën me Nr.406 të datës 22.01.2018 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti më datë 29.12.2017 ka mbaruar studimet në Fakulteti Juridik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren duke marr titullin Bachelor në Juridik, dhe po ashtu posedon Diplomën e datës 19.02.2021 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti me datë 20.10.2020 ka mbaruar studimet Master në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, ndërsa sipas Vendimit Ref.Nr.266/2248 të datës 19.07.2021 të Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është nostrifikuar diploma e fituar në Universitetin e Tiranës, po ashtu sipas Certifikatës SKPK/DBNJ/Nr.27 të datës 27.03.2029 të lëshuar nga Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës ka kryer praktikën nga data 20.03.2018 deri më datë 19.03.2019, e cila periudhë kohore njëkohësisht i llogaritet edhe përvojë e punës profesionale. Ashtu, edhe kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomën me Nr. 1751/2021 të datës 31.08.2021 përmes të cilës dëshmohet se e njëjta me datë 18.06.2019 ka mbaruar studimet në Kolegjin AAB duke marr titullin LLB në Juridik-Juridik i Përgjithshëm, sikurse e njëjta në bazë të Kontratës për Punë Praktike Vullnetare në Prokuroritë e Shtetit me numër 37/2021 të datës 01.12.2021 dëshmohet se ka lidhur marrëdhënie punë vullnetare në Këshillin Prokurorial të Kosovës nga data 01.12.2021 dhe deri në momentin e aplikimit në konkursin e lartë cekur me datë 05.09.2022 i ka pasur nëntë (9) muaj përvojë pune në këtë pozitë, ndërsa sipas Vërtetimit të datës 25.08.2022 të lëshuar nga MSR Selimaj-Avokaturë & Konsulencë Financiare dëshmohet fakti se e njëjta ka qenë e angazhuar për periudhën kohore nga data 01.07.2021 deri me datë 01.10.2021 në cilësi të praktikantes, nga rrjedh se kandidatja e përzgjedhur në momentin e aplikimit e ka përmbushur kriterin kohore prej dymbëdhjetë (12) muajsh apo një (1) viti të përvojës së punës.

Sa i përket plotësimi të kushteve nga kandidati i rekomanduar për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se kandidati i rekomanduar posedon Diplomën me Nr. 7118 të datës 02.11.2020 përmes të cilës dëshmohet se më datë 07.09.2020 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", duke e marr titullin Jurist i Diplomuar, ndërsa në bazë të Kontratës për Punë Praktike Vullnetare në Prokuroritë e Shtetit me numër 9 të datës 28.05.2022 dëshmohet se ka lidhur marrëdhënie punë vullnetare në Gjykatën e Apelit të Kosovës duke e kryer praktikën nga data 01.03.2021 deri më datë 28.02.2022, nga rrjedh se kandidati i përzgjedhur në momentin e aplikimit e ka përmbushur kriterin kohor prej dymbëdhjetë (12) muajsh apo një (1) viti të përvojës së punës

Kolegji i Këshillit, bazuar në këtë konstaton se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përfshirjes sikurse të ankuesit dhe kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren, ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili ka përcaktuar se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1. arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2 përvojën e punës"*.

Po ashtu, Kolegji i Këshilli ka konstatuar se testi me shkrim për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" për Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren, i mbajtur me datë 16.09.2022, ka qenë i përpiluar në pajtueshmëri me nenin 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi që Pjesa e I-parë testit-Pjesa e Njohurive të Përgjithshme është përberë nga tre (3) ese, Pjesa e II-dytë e testit-Pjesa e Aftësive të Përgjithshme dhe të Personalitetit, është përbërë nga dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta, si dhe Pjesa e III-tretë e testit- Pjesa e Njohurive lidhur me Vendin e Punës është përberë nga gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje, prej tyre gjysma me përgjigje të shumëfishta dhe gjysma në formë eseje të shkurtra. Nga shqyrtimit i formularëve të vlerësimit të testit me shkrim, Kolegji ka gjetur se ankuesi në testin me shkrim për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovës ka arritur të marr gjithsej 57 pikë, ndërsa kandidatja e përzgjedhur ka arritur të marr gjithsej 62 pikë, ndërsa për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren ankuesi në testin me shkrim ka marr gjithsej 57 pikë ndërsa kandidati i përzgjedhur ka marr gjithsejtë 75 pikë. Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të vlerësimit të testit me shkrim të njëjtin e ka analizuar edhe sipas çelësit të përgjigjeve të testit, rrjedhë se Komisioni Përzgjedhës vlerësimin e testit me shkrim për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren e ka bërë në pajtueshmëri me nenin 37 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, rrjedhimisht gjatë këtij procesi të vlerësimit të testit me shkrim Kolegji i Këshillit nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi e cila mund ta ketë favorizuar respektivisht dëmtuar ndonjërin nga kandidatët në procedurë rekrutimi dhe me rastin e ftesës për intervistim me gojë komisioni përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil nenit 36 paragrafit 2, i cili përcakton: *"kandidatët të cilët kalojnë me sukses testin me shkrim ose arrijnë të mbledhin 50% të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë"*.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se nuk janë publikuar pikët e testit me shkrim, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Vendimit A.nr.1234/2022,

lëndën e ka kthyer në rishqyrtim tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me qëllim të arsytimit të kësaj çështje, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës përmes Vendimit KA.Nr.15/2023 ka arsyetuar faktin se ankuesi është njoftuar për rezultatin e testit me shkrim në të dyja pozitat në të dy prokuroritë, si në rastin kur i është aprovuar pjesërisht kërkesën për qasje në dokumentet publike dhe të njëjtat dokumentacione që i janë dorëzuar ankuesit edhe ankuesi i ka dërguar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes ankesës, e që dëshmohet se janë të evidentuara pikët e testit me shkrim dhe me gojë për të dyja pozitat në të dyja prokuroritë respektive ku ankuesi ka aplikuar. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore e parapara me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ngase janë respektuar të njëjtat në këtë proces.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se në testin me gojë për Prokurorinë Themelore në Gjakovë njëri nga anëtarët e komisionit për njohuritë që lidhen me vendin e punës më ka vlerësuar më zero pikë ndërsa anëtarët e tjerë me kanë vlerësuar me pikë të tjera, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi në ankesën e datës 08.11.2022 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk ka pasur një pretendim të tillë, kështu që as Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk mund ta shqyrtoj një pretendim të tillë për shkak që ndaj këtij pretendimi nuk janë shtjerr burimet e brendshme të ankesave sipas legjislacionit përkatës.

Nga shqyrtimi i Formularit të përmbledhjeve të vlerësimeve individuale të kandidatëve lidhur me testimin me shkrim dhe me gojë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, rrjedh se kandidatja e përzgjedhur ka qenë kandidati me më së shumti pikë të grumbulluara gjithsejtë 69.9 pikë, ndërsa ankuesi është renditur i shtati me radhë me gjithsejtë 43.8 pikë, ndërsa për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren, nga shqyrtimi i Formularit të përmbledhjeve të vlerësimeve individuale të kandidatëve lidhur me testimin me shkrim dhe me gojë, rrjedh se kandidati i përzgjedhur ka qenë kandidati me më së shumti pikë të grumbulluara gjithsej 77.6 pikë, ndërsa ankuesi është renditur i pesti me radhë me gjithsej 48.1 pikë.

Nisur nga këto që u thanë më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se në shërbimin civil emërohen kandidatë që kanë numrin më të madh të pikëve siç parashihet me nenin 40 paragrafi 1 i Rregullores 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i përcakton se: *“në Shërbimi Civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë”*, rrjedhimisht në këto pozita janë emëruar kandidatët që kanë marrë numërim më të madh të pikëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në arsytimin e këtij vendimi, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren, ka vepruar në pajtueshmëri me të Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 paragrafi 1 i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me*

transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës", ngase nuk është vërtetuar asnjë shkelje procedurale dhe materiale sikurse pretendonte ankuesi dhe si e tillë ankesa e ankuesit është e pabazuar e cila është refuzuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër KA.Nr.15/2023 të datës 09.03.2023, përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 08.11.2022, ndërsa e kanë lënë në fuqi Njoftimin e datës 06.10.2022 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, pasi që ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.634/2023, datë 05/05/2023.

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.